



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 215 prot.

Tiranë, më 07. 02. 2018

**V E N D I M**

**Nr. 41, Datë 07. 02. 2018**

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 127, datë 27.09.2017, nga J. P., ku pretendon diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike dhe moshës*” nga ana e Bashkisë Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

Sipas shpjegimeve të dhëna, J. P. prej vitit 1980 deri në vitin 2010, ka jetuar në një banesë me qera, në pronësi të Bashkisë Korçë. Gjatë këtyre viteve ankuesja ka kërkuar të privatizojë banesën në të cilën jetonte, por nuk është pranuar nga institucionet përgjegjëse. Sipas ankueses, në vitin 2010 në mënyrë të padrejtë banesa në të cilën jetonte është marrë nga persona të tjerë. Në këto kushte, ankuesja është vendosur në një banesë tjetër, ku një pjesë të qirasë ia subvencionon Bashkia Korçë, ndërsa pjesën e mbetur e paguan vetë. Ankuesja dhe djali i saj, G. P. kanë aplikuar pranë Bashkisë Korçë në vitin 2010 e në vazhdim për të përfituar banesë me kredi të butë dhe nuk i është dhënë kjo mundësi nga ana e këtij institucioni.

Përsa më lart, J. P. kërkon të ndërmerren masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Korçë, për përfitimin e një banese me kredi të butë, pasi ajo i plotëson nivelin e të ardhurave për të përfituar nga ky program strehimi.

Diskriminimi për shkak të *gjendjes ekonomike dhe moshës*, janë shkaqe të mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikohet se “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë*

*me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".*

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

1. Mbështetur në nenin 33, pika 5 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me anë të shkresës nr. 938/1 prot., datë 20.10.2017, u kërkua nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, plotësimi i ankesës nga ana e ankueses dhe informacion shtesë për shqyrtimin e mëtejshëm të saj.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar J. P., me anë të shkresës datë 15.11.2017 vuri në dispozicion të KMD-së informacionin e kërkuar për pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e mëtejshëm të saj.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 5 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me shkresën nr. 938/2 prot., datë 14.12.2017, është bërë njoftimi i Bashkisë Korçë, nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me nisjen e procedurave të shqyrtimit të ankesës, si dhe është kërkuar informacion mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Me shkresën<sup>1</sup> nr. 5722/1 prot., datë 29.12.2017, Bashkia Korçë, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesja, J. P., ku ndër të tjera sqaroi se familja e saj është trajtuar me strehim në banesat me qera sociale që Bashkia Korçë ka ndarë në Shtator 2014. Bazuar në kërkesën dhe aplikimin e tyre, Këshilli Bashkiak Korçë me VKB nr. 76, datë 19.08.2014, ka përzgjedhur familjen e J. P. si përfituese. Në certifikatën familjare të paraqitur nga ana e tyre, kanë qënë dy persona (S. dhe J. P.) dhe ju është ofruar një garsonierë prej 32 m<sup>2</sup>.

Më datë 10.06.2016, Bashkia Korçë i është drejtuar S. P. ku e informon se kanë qënë aplikant dhe përfitues të programit të strehimit në banesat me qera sociale. Për këtë arsye, nisur nga përbërja e familjes prej dy personash, nga ana e Zyrës së Strehimit të Bashkisë, u është ofruar një garsonierë 37 m<sup>2</sup>. Për shkak të moshës së tyre, u është dhënë mundësia të zgjidhnin një kat të përshtatshëm dhe është refuzuar me pretendimin se kanë nevojë për më shumë sipërfaqe banimi. Nga ana e Bashkisë u është ofruar edhe një mundësi të dytë, në një nga garsonerat e mëdha prej 48 m<sup>2</sup>, e cila u lirua nga një familje që nuk përmbushi detyrimin kontraktual të pagesës së qirasë. Duke qënë se edhe këtë kanë refuzuar, pasi sipas legjislacionit, e kanë humbur mundësinë për të përfutuar banesë sociale për shkak të refuzimit të mundësive të ofruara.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>1</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 43 prot., datë 10.01.2018

**Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:**

**Lidhur me trajtimin ndryshe dhe të pafavorshëm**

Mbështetur në informacionin dhe provat e administruara, rezultoi se shtetësja J. P. dhe bashkëshorti i saj, kanë aplikuar pranë Bashkisë Korçë për të përfituar nga programi i banesave sociale me qira në vitin 2014, ku kanë dalë përfitues të këtij programi. Për shkak të moshës së tyre, nga ana e Bashkisë Korçë u është dhënë mundësia e zgjedhjes së një apartamenti 3 (tre) herë, por nga ana e tyre është refuzuar, duke humbur kështu të drejtën për të përfituar nga ky program social. Aktualisht, ankuesja është përfituese e subvencionit të një pjese të qirasë nga ana e Bashkisë Korçë.

Përsa më lart dhe duke marrë shkas nga ankesa e bërë nga ankuesit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi legjislacionit në fuqi, lidhur me programet e strehimit dhe konstatoi se:

Ligji Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për Programet Sociale të Strehimit”, i ndryshuar, në nenin 4, ku përcaktohen familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit, parashikon se:

*“1. Sipas këtij ligji, përfitojnë strehim individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:*

*a) nuk kanë në pronësi një banesë;*

*b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;*

*c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.*

*2. Përfshihen në njërën nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të neneve 6 e 19 të këtij ligji.*

*3. Përfitojnë sipas programeve të përcaktuara në krrerët III dhe IV të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin:*

*a) “punëtor emigrant”;*

*b) “azilkërkues”.*

*4. Administrimi i kërkesave për përfitimin nga programet sociale të strehimit dhe caktimi i përparësive bëhen nga strukturat përkatëse të organeve të qeverisjes vendore dhe miratohen me vendim të këshillave të njësisive të qeverisjes vendore, përveç rasteve kur në ligje të veçanta përcaktohet ndryshe.*

*5. Dokumentacioni, që duhet të paraqesë familja për të përfituar strehim, sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, dhe afatet e procedurat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

*6. Normat për përfitimin e strehimit, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*

Në nenin 17, të ligjit të sipërcituar parashikohet se: *“1. Familjet që klasifikohen për t'u trajtuar me banesa me kosto të ulët janë: a) familjet që në çastin e paraqitjes së kërkesës pranë zyrës përkatëse*

të njësisë së qeverisjes vendore nuk kanë në pronësi një banesë; b) familjet, që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit; c) familjet, që kanë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji. 2. Normat e strehimit, sipas shkonjës "b" të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Administrimi i kërkesave për këto banesa bëhet nga struktura përkatëse në njësitë e qeverisjes vendore.”

Në të njëjtën frymë qëndron edhe pika 2 e VKM-së Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, në të cilën parashikohet se: “2. Sipërfaqja minimale e banimit, që i takon një personi të vetëm, sipas shkonjës "a" të pikës 1 të këtij vendimi, është 12.5 m<sup>2</sup>. Çdo personi tjetër shtesë mbi të parin, me moshë mbi 10 vjeç, i takon 7.5 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, ndërsa çdo personi tjetër shtesë me moshë nga 5 vjeç deri në 10 vjeç i takon 3.75 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi.”. Gjithashtu, përcaktohet se për një familje të përbërë nga dy persona, sipërfaqja e banimit duhet të jetë maksimalisht 20-21 m<sup>2</sup>.

Përfituesit e programeve sociale të strehimit duhet të përmbushin njërin prej kritereve të mëposhtme: nuk kanë në pronësi një banesë; zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit; ose kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore (Ligji nr. 9232, neni 5). Përzgjedhja e përfituesve mbështetet tek kushtet e tyre të jetesës si edhe tek rrethanat e tyre shoqërore dhe ekonomike. Përparësi u jepet 15 grupeve, përfshirë familjet me një prind të vetëm, familjet e mëdha, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendqëndrim, jetimët, emigrantët e rikthyer, punëtorët migruer, azilkërkuessit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje, familjet rome, familjet egjiptiane dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Mbështetur në provat e administruara, rezultoi se nga ana e Bashkisë Korçë i është dhënë mundësia e përzgjedhjes së një banese me qera, por është refuzuar disa herë prej saj.

**Në përfundim, pretendimet e shtetases J. P. se mosha dhe gjendja e saj ekonomike janë bërë shkak për trajtimin në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë, nuk mbështetet në asnjë nga provat dhe faktet e administruara nga Komisioneri gjatë procedurave hetimore.**

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të moshës dhe gjendjes ekonomike, së shtetases J. P., nga ana e Bashkisë Korçë.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**KOMISIONERI**

---

**Irma BARAKU**

(Shkaku: Mosha dhe gjendja ekonomike)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)